



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1391 Prot.

Tiranë, më 07.11 2019

VENDIM Nr. 228, datë 31.10.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 31.10.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Lushnjës*, "Ujësjellës Kanalizime Lushnje" sh.a, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Lushnjës*, "Ujësjellës Kanalizime Lushnje" sh.a, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Subjekti "Ujësjellës Kanalizime Lushnje" sh.a, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin *"Infrastruktura Bashkiake IV", për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Lushnjës*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Në rrënojat buzë lumit, në fshatin Çermë e Sipërme, të kryhet një sondazh arkeologjik nga ASHA, për sqarimin e datimit dhe funksionin e këtyre rrënojave.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTQ

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al